

**FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS**  
**Komisioni disiplinor – shkalla e parë**  
**Prishtinë, date 21.02.2020**

Komisioni disiplinor i shkallës së parë në mbledhjen e mbajtur me datë 21.02.2020 rishqyrtoi lëndën e kthyer nga organi disiplinor i shkallës së dytë lidhur me dënimin e klubit të futbollit “ Besa “ nga Peja me marrjen e tri pikëve negative dhe nga e njeta duke iu referuar kushteve dhe rrethanve ekzistuese konform Dispozitave të Rregullores disiplinore neni 110 paragrafi 3 pika a dhe b sjelli këtë ;

### **V E N D I M**

1. Pezullohet ( hiqet ) vendimi i shqiptuar i organit disiplinor të shkallës së parë date 18.10.2019 lidhur me dënimin e klubit të futbollit “ Besa “ nga Peja me marrje të 3 ( tri ) pikëve negative
2. Klubit të futbollit “ Besa “ nga Peja i kthehen pikët e marrura nga vendimi i datës 18.10.2019

### **A r s y e t i m**

Në rastin e rishqyrtimit të rastit komisioni disiplinor vertetoi se ka pushuar arsyeja për suspendim nga shkaku se klubi futbollistik “ Besa “ nga peja ka përmbushur ( paguar ) obligimet e tërësishme të shumës së të hollave të theksuara në dënimin apo përmbushjen e obligimeve financiare ndaj lojtarëve i cili e ka shkaktuar suspendimin .

### **KËSHILLA JURIDIKE**

Pala e pakënaqur në këtë vendim ka të drejtë ankese drejtuar organit disiplinor të shkallës së dytë në afatin kohor të paraparë me aktet normative të Federatës së Futbollit të Kosovës.

**Prishtinë, date 21.02.2020**

**Komisioni disiplinor, shkalla e parë, kryetari Dukagjin Zefi d.v.**

